



**Prishtinë, 13 qershor 2018**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_986\_2018**

### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

#### **Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 14, nenin 15 paragrafi 1 dhe nenin 16 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja;
- Nenin 11 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 7, nenin 17 paragrafi 5, nenin 21 paragrafin 1 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë;
- Vendimin nr. V\_810\_2016, të datës 19 maj 2016, për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë;
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lokacionin HC Soponica 2, ZK Soponicë me kapacitet të instaluar prej 3 MW, komuna e Kaçanikut, Republika e Kosovës;
- Vendimin nr. V\_855\_2016, të datës 11 nëntor 2016, për lëshimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për shoqërinë "Hidro Forca" Sh.p.k., për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga Hidrocentrali, në Lokacionin HC Soponica 2, ZK Soponicë me kapacitet të instaluar prej 3 MW, komuna e Kaçanikut;
- Kërkesën/aplikacionin për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lokacionin HC Soponica 2, ZK Soponicë me kapacitet të instaluar prej 3 MW, komuna e Kaçanikut, të datës 08.12.2017, të shoqërisë "Hidro Forca" Sh.p.k., me adresë: rruga e "Mentoj Tolaj" nr. 87, Deçan, Republika e Kosovës, dhe
- Kontratat, lejet, pëlqimet dhe vendimet e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, si në shtojcën II. të këtij vendimi,



në seancën e mbajtur më 13 qershor 2018 nxori këtë:

## V E N D I M PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT FINAL

- I. I lëshohet **AUTORIZIMI FINAL** shoqërisë “**Hidro Forca**” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC Soponica 2 me kapacitet të instaluar prej **3 MW**, në rrjedhën e Lumit Lepenc në segmentin nga kuota 553 m deri në kuotën 520 m, në ngastrën kadastrave Nr. 465-0, sipas Lejes Ndërtimore 06 351/1-30565/17 e datës 18.04.2018 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Kaçanikut.
- II. Vendimi për Autorizim Final i lëshohet shoqërisë “Hidro Forca” SH.P.K., për dy (2) vite, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të ndërtoj stabilimentet e reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin të finalizuar nga data e lëshimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent sipas Ligjit për Ndërtimin.
- IV. Shoqëria “Hidro Forca” SH.P.K., do të lidh Marrëveshjen për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Operatorin e Tregut(KOSTT) në kohëzgjatje 10 (dhjetë) vjeçare, e cila do të lidhet brenda tridhjetë (30) dite nga data e lëshimit të këtij vendimi, me tarifën nxitëse të përcaktuar me vendimin nr. V\_810\_2016, të datës 19 maj 2016, të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së.
- V. Shoqëria “Hidro Forca” SH.P.K., obligohet që të pajiset me Leje Mjedisore (Ekologjike) të lëshuar nga MMPH.

### A r s y e t i m

- o ZRRE, me datë 23.08.2016 nga shoqëria “Hidro Forca” Sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike Hidrocentrali në Lokacionin HC Soponica 2, ZK Soponicë, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, Komuna e Kaçanikut, Republika e Kosovës.
- o ZRRE, pas konstatimit se apikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, më 11 nëntor 2016 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_855\_2016 dhe ka udhëzuar aplikuesin që t’i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- o Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_855\_2016 nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit Final për Ndërtim, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.



- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar është lëshuar në afat një (1) vjeçar dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqërisë “Hidro Forca” SH.P.K. do t’i jepet Autorizimi Final për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim Final, duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar disponueshmërinë e caqeve si dhe pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse dhe garantimin automatik të tarifës nxitëse, dhe garantimin e lidhjes së Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë (MBE) në kohëzgjatje 10 (dhjetë) vjeçare.
- ZRRE, me datë 03.11.2017 nga shoqëria “Hidro Forca” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit V\_855\_2016 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lokacionin HC Soponica 2, ZK Soponicë, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, Komuna e Kaçanikut, për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës dhe dëshmimeve relevante me datë 29.03.2018 ka aprovuar kërkesën me Vendimin V\_939\_2018 për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_855\_2016 dt. 11 nëntor 2016, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me 11 maj 2018, në mënyrë që brenda kësaj periudhe të kompletohet aplikacioni për marrjen e Autorizimit Final.
- ZRRE, më 08.12.2017, nga shoqëria “Hidro Forca” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lokacionin HC Soponica 2, ZK Soponicë, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, Komuna e Kaçanikut, duke i bashkëngjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore dhe ujore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës dhe Lejen Ndërtimore si dhe kërkesat tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- ZRRE, pas vlerësimit të dëshmimeve të bashkangjitura dhe lejeve, pëlqimeve dhe vendimeve të lëshuara nga institucionet përgjegjëse dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**VI.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

**VII.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

*Bashkëngjitur Vendimit janë Shtojca I dhe Shtojca II.*

**Bordi i ZRRE-së:**

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Kaçanikut,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.



## SHTOJCA I

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) duke ushtruar kompetencat e dhëna me nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe në përputhje me Nenin 16 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja, shoqërisë “Hidro Forca” SH.P.K., me adresë: rruga e “Mentoj Tolaj” nr. 87, Deçan, Republika e Kosovës, më **13 qershor 2018**, i lëshon këtë:

### AUTORIZIM

1. Për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC Soponica 2 me kapacitet të instaluar prej **3 MW**, në rrjedhën e Lumit Lepenc në segmentin nga kuota 553 m deri në kuotën 520 m, në ngastrën kadastrave Nr. 465-0, sipas Lejes Ndërtimore o6 351/1-30565/17 e datës 18.04.2018 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Kaçanikut.
2. Me këtë Autorizim autorizohet shoqëria “Hidro Forca” SH.P.K., që të ndërtoj kapacitetet gjeneruese në lokacionin e caktuar më lart, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Autorizim.
3. Ky Autorizim lëshohet për dy (2) vite duke filluar nga data e lëshimit të tij. ZRRE me kërkesë të palës mund ta vazhdoj vlefshmërinë e Autorizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Pala e Autorizuar, gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së këtij Autorizimi, duhet të plotësojë:
  - a. të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë Autorizim, dhe
  - b. të gjitha kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe ato për mjedisin.
5. Zyra e Rregullatorit për Energji mund ta bëjë modifikimin e këtij Autorizimi në përputhje me dispozitat e nenit 21 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
6. Në rast se pala e Autorizuar falimenton para se të ndërtohet stabilimenti gjenerues i autorizuar, atëherë ky Autorizim do të pezullohet dhe do të mbetet i tillë derisa ZRRE përcakton se janë arritur kushtet për tërheqjen e pezullimit. Derisa ky Autorizim është i pezulluar e tërë puna e mëtutjeshme në ndërtimin e stabilimentit gjenerues të autorizuar duhet të ndërpritet. Në rast të kundërt, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
7. Vlefshmëria e këtij Autorizimi do të përfundojë me skadimin e afatit të përcaktuar në dispozitivin nën II. të këtij Vendimi, apo me skadimin e afatit shtesë të përcaktuara nga ZRRE në përputhje me pikën 3 të shtojcës I. të këtij Autorizimi.
8. Në rast se pala e Autorizuar bën shkeljen e ndonjërit prej kushteve të këtij Autorizimi dhe të dispozitave ligjore në fuqi, ZRRE do të pezullojë këtë Autorizim në përputhje me dispozitat e Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Nga data e pezullimit të Autorizimit e tërë puna e mëtutjeshme në stabilimentin e autorizuar do të ndërpritet. Në rast të mos respektimit të kushteve ligjore, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara sipas legjislacionin në fuqi.
9. Pala e autorizuar duhet ta njoftoj me shkrim ZRRE-në dhe të kërkojë pëlqimin paraprak për çdo ndërrim të ndonjë pjese të elementeve ekzistuese të gjeneratorëve apo shtim të elementeve të reja, e që nuk janë të përfshira në projektin që është pjesë e aplikacionit.



## SHTOJCA II

Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve, kontratave etj.) të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës lidhur me marrjen e **Autorizimin Final për Ndërtim** të shoqërisë NPN "Renelual Tahiri" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Lumin Lepenc HC Soponica 2 me kapacitet të instaluar prej **3 MW**, ZK Soponicë, komuna e Kaçanikut:

- **Pëlqimi** - nr. 06. Nr. 16-16499 dt. 18.05.2016 i lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër, dhe Mbrojtje të Mjedisit.
- **Pëlqimin Mjedisor** - nr. 16/2844/1-495/DMM i datës 24.11.2016 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) –Zyra e Sekretarit Permanent (ZSP);
- **Pëlqimi Ujor** – nr. 402/17 –ZSP – 226/2017 i datës 08.02.2017 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) –Zyra e Sekretarit Permanent (ZSP);
- **Pëlqimi Elektroenergjetik** - nr. 5782, dt. 04.06.2018 i lëshuar nga KEDS SH.A.;
- **LEJA NDËRTIMORE** – 06 Nr.351 /01-30565 të datës 18.04.2018 për Lejimin e ndërtimit të hidrocentralit, HC Soponica 2 me kapacitet të instaluar prej **3 MW**, në rrjedhën e Lumit Lepencë në segmentin nga kuota 553 m deri në kuotën 520 m, në ngastrën kadastrave Nr. 465-0, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Kaçanikut.
- **Certifikatat e ngastrave kadastrale dhe kopjet e planit.**
- **Studimi i Fizibilitetit teknik, mjedisor dhe financiar.**
- **Plani i Biznesit.**
- **Projekti i Zbatimit Final.**